



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	
DRŽAVNA AGENCIJA ZA ZAŠTITU LIČNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZEMË E KOSOVË - KOSOVO	
ZEMË E KOSOVË - KOSOVO	
Num. Orig. Data Stat.	01
Nr. Prot. Itr. Prot. Prot. Num.	215
Num. Regjive Data Data	02
	14/10/2013
PRISHTINË/A	



Nr. prot. 40/2013
Datë: 14.10.2013

Në mbështetje të nenit 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2) të Ligjit Nr.03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 70/31 maj 2010), Mbikëqyrësi Shtetëror merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet vëzhgimi me kamerë në ashensorë.
2. Ndalohet përpunimi i karakteristikave biometrike (gjurmët e gishtërinjve) për të punësuarit në "Gorenje Niti Tiki Company SH.A."
3. "Gorenje Niti Tiki Company SH.A." në afat prej 15 ditësh ta njoftojë Agjencinë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 (paragrafi 1, 1.4.) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), më datë 08.10.2013, Agjencia ka zhvilluar një inspektim të rregullt sipas detyrës zyrtare në "Gorenje Niti Tiki Company SH.A." Pas inspektimit është përpiluar procesverbali me nr.15/2013, i cili është nënshkruar nga mbikëqyrësi shtetëror dhe z. Agim Mustafa në emër të "Gorenje Niti Tiki Company SH.A." dhe të njëjtit i është dorëzuar një kopje.

Në bazë të inspektimit të bërë, në procesverbal është konstatuar kjo gjendje:

Në hapësirat e "Gorenje Niti Tiki Company SH.A." bëhet vëzhgimi me kamera. Shenjat paralajmruese janë të vendosura.

Përveç në hapësirat tjera, vëzhgimi me kamerë bëhet edhe në ashensor.

Në "Gorenje Niti Tiki Company SH.A." bëhet përdorimi i karakteristikave biometrike, përkatësisht merren shenjat e gishtërinjve për të kontrolluar hyrje-daljet e punëtorëve në/nga ndërtesa.

Dosjet (të dhënat personale) e të punësuarëve mbahen në hapësirat e përshtatshme.

Në nenin 64 (paragrafi 3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që vëzhgimi me kamerë ndalohet në hapësirat jashtë vendit të punës, veçanërisht në dhoma të ndërrimit, ashensorë, hapësira sanitare, etj.

Në nenin 68 (paragrafi 1) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që sektori privat mund të përdorë karakteristikat biometrike vetëm nëse kjo është e domosdoshme për kryerjen e aktiviteteve për sigurinë e njerëzve, për sigurimin e pronës ose për mbrojtje të të dhënave konfidenciale ose sekreteve të biznesit. Të punësuarit duhet të informohen paraprakisht në formë të shkruar për përdorimin e karakteristikave të tyre biometrike, rreth masave që do të merren dhe të drejtat e tyre.

Në nenin 68 (paragrafi 2) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që nëse nuk është paraparë ndryshe me ligjin përkatës, kontrolluesi i të dhënave duhet që para marrjes së masave për përdorimin e karakteristikave biometrike t'i ofrojë Agjencisë përshkrimin e detajuar për masat që do të merren duke përfshirë informacionet që do t'i jepen subjektit të të dhënave, arsyet për marrjen e masave dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në nenin 68 (paragrafi 3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që pas marrjes së informacionit nga paragrafi 2 i këtij neni, Agjencia, brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të vendosë nëse informacioni i marrë lidhur me masat është në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Në nenin 68 (paragrafi 4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashihet që kontrolluesit e të dhënave mund të zbatojnë masat për përdorimin e karakteristikave biometrike, pas marrjes së autorizimit nga Agjencia.

Siç është përshkruar në arsyetimin e këtij vendimi, bazuar në nenin 49 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.2) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mbikëqyrësi shtetëror ka marrë vendimin e paraqitur në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë, por mund të hapet konflikt administrativ në gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Vendimi i dërgohet:

- "Gorenje Niti Tiki Company SH.A."
- Arkivit të Agjencisë

